

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6892
E enjte, 11 maj 2023
Çmimi 0.40 €

QIRINJTË E
DYFYTYRËSISË! | FAQE 5

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARLAMENTI EVROPIAN MIRATON RAPORTET PËR KOSOVËN DHE SERBINË | FAQE 4-5

BËHET THIRRJE QË KOSOVA DHE SERBIA TË JENË KONSTRUKTIVE NË DIALOG



Parlamenti Evropian ka miratuar dy rezoluta vjetore për Kosovën dhe Serbinë "përmes të cilave u bëhet ftesë të dyja vendeve që të jenë konstruktive në dialogun për normalizimin e raporteve dhe ky

normalizim duhet ta përfshijë edhe njohjen e ndërsjellë". Në raportin për Kosovën përsëritet ftesa për pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ta bëjnë një gjë të tillë. Këto janë

raportet e fundit vjetore për Kosovën dhe Serbinë nga përbërja aktuale e Parlamentit Evropian, pasi në fund të majit apo në fillim të qershorit të vitit 2024 do të mbahen zgjedhjet evropiane

KURTI THOTË SE QEVERISJA LOKALE PO I BËN OPOZITË NIVELIT QENDROR | FAQE 3



SHBA-ja E
SHQETËSUAR NGA
RAPORTIMET PËR
SHITBLERJE TË
VOTAVE NË SHQIPËRI
| FAQE 2

OPINION

KUSH DËSHIRON TË HEQ EMRIN
HASAN PRISHTINA, SIMBOLIN
QË MISHËRON LUFTËN PËR
PAVARËSI KOMBËTARE? | F. 6

Bardhyl MAHMUTI,
politolog



AKTUALE



"DHOMAT E SPECIALIZUARA
PO VAZHDOJNË TË KRIJOJNË
VONESA ARTIFICIALE NË PROCESIN
GJYQËSOR KUNDËR KRERËVE TË
UÇK-SË" | F. 3

MINISTRJA HAXHIU PRET
REZULTATE BRENDA AFATEVE
TË PËRCAKTUARA PËR
REFORMËN NË DREJTËSI | F. 5

EKONOMI



MUNGESA E PUNËTORËVE
I DETYRON BUJQIT
T'I ZVOGËLOJNË TË MBJELLAT | F. 8

SONDAZHI I PYPER-it: INFLACIONI,
SHQETËSIMI KRYESOR
I QYTETARËVE NË KOSOVË | F. 7

SPORT

SONTE BETEJA E TRETË MES
TREPÇËS DHE PEJËS | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja e shqetësuar nga raportimet për shitblerje të votave në Shqipëri

TIRANË, 10 MAJ - Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Yuri Kim, shprehu shqetësim për raportimet për shitblerje vote katër ditë para mbajtjes së zgjedhjeve lokale.

Kryediplomatja amerikane kërkoi që përballë këtyre raportimeve autoritetet shqiptare të reagojnë. "Të gjithë ata që kanë të drejtë vote duhet të votojnë. Kemi parë raportime për blerje dhe shitje votash dhe shpresojmë që autoritetet do ta bëjnë detyrën e tyre. Nëse disa po thonë se po blejnë vota për një parti politike, ndaj kësaj partie politike duhen ndërmarrë veprime", tha ambasadorja Kim. Këto deklarata të ambasadores Kim vijnë katër ditë para mbajtjes së zgjedhjeve vendore,



në të njëjtën dikur kur policia shqiptare njoftoi se ka arrestuar një person dhe një tjetër është liruar në procedurë të rregullt për

shkak se ata po diskutonin për shitblerje votash për një subjekt politik.

Në videon e publikuar në media

në Shqipëri, flitet për shuma deri në 15 mijë lekë (135 euro) për katër vota.

Shitblerja e votës është një nga

problemet kryesore që është raportuar në çdo proces zgjedhor në Shqipëri. Edhe në raportin e ODIHR për zgjedhjet e fundit të zhvilluara në Shqipëri më 25 prill të vitit 2021, theksohet se "ashtu si në zgjedhjet e mëparshme, pretendimet e besueshme të blerjes së votës ishin të pranishme gjatë dhe pas fushatës dhe hetimet filluan në një numër çështjesh. Pretendime të tilla nuk ishin të kufizuara në asnjë parti".

OSBE/ODIHR rekomandoi që agjencitë e zbatimit të ligjit t'i shtojnë përpjekjet për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e blerjes së votave. Më 14 maj në Shqipëri votohet për t'i zgjedhur kryetarët e 61 bashkive dhe këshilltarët e rinj bashkiakë.

Biden dhe McCarthy pajtohen t'i vazhdojnë bisedimet për rritjen e tavanit të borxhit

WASHINGTON, 10 MAJ - Presidenti amerikan Joe Biden dhe ligjvënësi kryesor republikan u pajtuan të martën për t'i vazhduar bisedimet që synojnë arritjen e një marrëveshjeje për rritjen e tavanit për borxhin prej 31.4 trilionë dollarësh.

Zyrtarët kanë afat edhe tri javë për të arritur marrëveshje ose vendi do të hyjë në procesin e paprecedentë të falimentimit.

Për një orë e gjysmë, në Zyrën Ovale, demokrati Biden, dhe kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, republikani Kevin McCarthy, diskutuan për një marrëveshje të mundshme para afatit të 1 qershorit.

Biden, McCarthy dhe tre liderë të

tjerë të lartë të Kongresit amerikan pritet të takohen sërisht të premten.

Presidenti amerikan tha se bisedimet ishin produktive dhe duket se ai u ka ofruar republikanëve disa kompromise të mundshme, përfshirë edhe fondet që nuk janë shfrytëzuar për ndihmë për pandeminë, me qëllim që të ulen shpenzimet qeveritare.

Por, ai përsëriti se republikanët duhet ta marrin seriozisht kërcënimin që paraqet një mosarritje e marrëveshjes. Ai nuk e përjashtoi as mundësinë që ta përdorë Amendamentin 14 të Kushtetutës amerikane, një amendament që nuk është

përdorur më parë dhe mund të cilësohet si veprim antikushtetues. "Çdonjëri në atë takim e kuptoi rrezikun e falimentimit", tha Bideni, duke shtuar se bisedimet do të vazhdojnë.

McCarthy tha se në takim pati mungesë të përparimit. "Nuk kam parë asnjë lëvizje të re", tha ai, duke shtuar se Bideni nuk u pajtua që bisedimet të vazhdojnë deri në afatin e fundit.

Ekonomistët kanë paralajmëruar se nëse nuk arrihet marrëveshje dhe shteti shkon në falimentim, atëherë ekonomia amerikane do të futej në një recesion të thellë, që do ta destabilizonte sistemin global financiar.



Bideni po kërkon nga ligjvënësit që të rritin tavanin e huamarrjes pa asnjë kusht. McCarthy, partia e të cilit ka shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, tha se ky

institucion nuk do të miratojë asnjë marrëveshje që nuk shkurton në mënyrë dramatike shpenzimet për ta adresuar rritjen e deficitit buxhetor.

Ushtria ukrainase thotë se po vazhdon rezistencën në Bahmut

BAHMUT, 10 MAJ - Mbrojtësit ukrainas po vazhdojnë të rezistojnë ndaj një vale të re të sulmeve ruse në qytetin lindor të Bahmutit pavarësisht se Rusia ka pretenduar se ka avancuar në këtë qytet, tha ushtria ukrainase më 10 maj.

Njoftimet për luftime të ashpra në Bahmut vijnë në kohën kur Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar për ndihmë të re ushtarake për Kievin dhe Bashkimi Evropian pritet që të diskutojë për paketën e re të sanksioneve për shkak të luftës që Moska ka nisur ndaj Ukrainës. Forcat ruse kanë kryer 46 sulme ndaj pozicioneve ukrainase në vijën e frontit Bahmut-Avdijivka-



Marjinka në rajonin lindor të Donjeckut, ku Moska ka

përqendruar përpjekjet kryesore të luftës, tha Shtabi i

Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase.

Përveç granatimeve të vazhdueshme, forcat ruse kanë përdorur avionë për t'i sulmuar pozicionet ukrainase në Avdijivka, tha ushtria.

Yevgeny Prigozhin, kreu i grupit rus të mercenarëve, Wagner, pretendoi se forcat e tij po bëjnë përparim në Bahmut. Por, në orët e vona të 9 majit ai akuzoi Ministrinë e Mbrojtjes së Rusisë se ka dështuar t'i furnizojë luftëtarët e tij me municion të mjaftueshëm dhe i akuzoi trupat ruse se po ikin nga luftimet përreth Bahmutit. Këto deklarata ishin të fundit në serinë e pakënaqësive që ai ka shprehur publikisht për zyrtarët ushtarakë rusë.

Kurti thotë se qeverisja lokale po i bën opozitë nivelit qendror

“Dikur niveli qendror i bënte opozitë qeverisjes lokale, sot qeverisja lokale në disa raste po përdoret për opozitë të nivelit qendror. Gabim ka qenë atëherë. Gabim është edhe tani. Bashkëpunimin e kemi përgjegjësi. Të dy nivelet e qeverisjes burojnë nga vullneti i qytetarëve. Prandaj, edhe duhet të jemi në shërbim të tyre”, është shprehur kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e qeverisë të mërkurën

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se qeverisja lokale po i bën opozitë nivelit qendror. Kryeministri Kurti në mbledhjen e qeverisë ka theksuar se dikur niveli qendror i bënte opozitë nivelit lokal, kurse tash po ndodh e kundërta, e cila, sipas tij, është gabim. “Javën tjetër do ta mbajmë takimin e radhës të përbashkët me kryetarët e komunave, të katërtin deri më tani, me qëllim mirëmbajtjen e komunikimit mes nivelit qendror dhe atij lokal dhe për të diskutuar për çështje me interes për qytetarët. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, që është edhe ministri i linjës, është në komunikim dhe dispozicion të përhershëm me krerët e komunave, pa dallim. Këto janë dëshmi të forta, sepse janë fakte

të qarta, të mbështetjes dhe gatishmërisë për bashkëpunim të afërt të qeverisë me komunat. Dikur niveli qendror i bënte opozitë qeverisjes lokale, sot qeverisja lokale në disa raste po përdoret për opozitë të nivelit qendror. Gabim ka qenë atëherë. Gabim është edhe tani. Bashkëpunimin e kemi përgjegjësi. Të dy nivelet e qeverisjes burojnë nga vullneti i qytetarëve. Prandaj, edhe duhet të jemi në shërbim të tyre. Qeveria është e të gjithëve. Edhe e komunave. E komunat janë të qytetarëve, jo të partive politike”, ka theksuar Kurti.

Kurti ka bërë me dije se para dy javëve Komisioni i Granteve mbajti një takim të rëndësishëm, në të cilin u miratua ndarja e granteve për komuna për periudhën 2024-2026. Ai ka thënë se buxheti i përgjithshëm komunal për vitin e ardhshëm arrin vlerën prej 742 milionë euro, që i bie gati 200

milione euro më shumë buxhet për komuna gjatë qeverisjes së tyre sesa gjatë qeverisë së mëparshme, apo rritje mbi 35%. “Ndërkaq, Granti i Përgjithshëm për Komuna për vitin 2024 kap shumën prej 284.7 milionë eurosh, e që paraqet vlerën më të madhe ndonjëherë për këtë grant. Kjo vlerë rekorde e Grantit të Përgjithshëm vjen si rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së të hyrave në Buxhetin e Shtetit. Rritje ka edhe në Grantin specifik për Shëndetësi dhe Grantin specifik për Arsim. Granti për Shëndetësi për vitin 2024 ka rritje prej 16% krahasuar me vitin 2023, apo 11.5 milionë euro, ndërsa Granti për Arsim është rritur për 18.5%, apo 37 milionë euro. Në atë mbledhje, Komisioni i Granteve miratoi buxhetin me rritje edhe për Grantin e Kryeqytetit me rreth 12% krahasuar me vitin 2023, si dhe Financimin për teatrot me

rritje prej 80%”, ka thënë Kurti. Kryeministri ka pohuar se në fillim të prillit, në një takim, ku ishin të ftuar të gjithë kryetarët e komunave, hapën thirrjen publike për komuna për masat e efijencës së energjisë për ndërtesat e banimit social, në

kuadër të pakos 75-milionëshe për përballje me krizën energjetike. Gjithashtu, ai tha se në maj të vitit të kaluar nënshkruan “Kartën për komunën e gjelbër dhe të qëndrueshme” në kuadër të agjendës së gjelbër.

Çitaku: Në qeverisje kemi një parti e cila ndarjen e pushteteve dhe rendin kushtetues i sheh si kërcënime

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, duke komentuar deklaratën e Kurtit se pushteti lokal po i bën opozitë, ka thënë se sot vendi ka në qeverisje një parti e cila ndarjen e pushteteve dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës i sheh si kërcënime. “Pra, në qeverisje kemi një parti e cila ndarjen e pushteteve dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës i sheh si kërcënime. Në demokracitë liberale Kushtetuta dhe ligji shërbejnë si pararojë për t'i kufizuar epshet, ambiciet, ndonjëherë edhe dëliret e politikanëve të papërgjegjshëm. Kushtetuta nuk është kërcënim. Mendësia totalitare është”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.

“Dhomat e Specializuara po vazhdojnë të krijojnë vonesa artificiale në procesin gjyqësor kundër krerëve të UÇK-së”

PRISHTINË, 10 MAJ - Ish-këshilltari i ish-presidentit Hashim Thaçi, Artan Behrami, ka thënë se Dhomat e Specializuara për rishkrimin e historisë së Kosovës po vazhdojnë të krijojnë vonesa artificiale në procesin gjyqësor kundër krerëve të UÇK-së. Ai ka thënë se në muajin prill janë intervistuar

vetëm tre dëshmitarë nga mbi 300 sa janë paralajmëruar nga Prokuroria. “Me këtë dinamikë, procesi gjyqësor kundër krerëve të UÇK-së do të zgjasë 9 vjet! Ata kanë thirrur ‘dëshmitarë’ pa emra dhe pa zë, larg syve të qytetarëve, duke ua ushqyer thashethemet, dezinformatat mbi të cilat kjo gjykatë është

krijuar! Ata janë të vetëdijshëm që transparenca është armiku më i madh i gënjeshtrove, rrjedhimisht armiku më i madh i kësaj gjykate. Në mungesë të fakteve, dëshmimeve, ata po investojnë në një proces të pafund dhe jotransparent”, ka shkruar Behrami në “Facebook”.





PARLAMENTI EVROPIAN MIRATON RAPORTET PËR KOSOVËN DHE SERBINË

Bëhet thirrje që Kosova dhe Serbia të jenë konstruktive në dialog

Parlamenti Evropian ka miratuar dy rezoluta vjetore për Kosovën dhe Serbinë “përmes të cilave u bëhet ftesë të dyja vendeve që të jenë konstruktive në dialogun për normalizimin e raporteve dhe ky normalizim duhet ta përfshijë edhe njohjen e ndërsjellë”. Në raportin për Kosovën përsëritet ftesa për pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ta bëjnë një gjë të tillë. Këto janë raportet e fundit vjetore për Kosovën dhe Serbinë nga përbërja aktuale e Parlamentit Evropian, pasi në fund të majit apo në fillim të qershorit të vitit 2024 do të mbahen zgjedhjet evropiane

EPOKA E RE

Fayon DËRMAKU

BRUKSEL, 10 MAJ - Parlamenti Evropian ka miratuar dy rezoluta vjetore për Kosovën dhe Serbinë “përmes të cilave u bëhet ftesë të dyja vendeve të jenë konstruktive në dialogun për normalizimin e raporteve dhe ky normalizim duhet të përfshijë edhe njohjen e ndërsjellë”.

Për raportin për Kosovën votuan 452 deputetë, 87 ishin kundër dhe 76 abstenuan.

Këto janë raportet e fundit vjetore për Kosovën dhe Serbinë nga përbërja aktuale e Parlamentit Evropian, pasi në fund të majit apo në fillim të qershorit të vitit 2024 do të mbahen zgjedhjet evropiane.

Tekstet e raporteve për Kosovën dhe Serbinë paraprakisht ishin miratuar në Komisionin për Politikë të Jashtme, ndërkaq tani atyre iu shtuan disa

amendamente të propozuara, që morën shumicën e votave të deputetëve evropianë.

Në raportin për Kosovën përsëritet ftesa për pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ta bëjnë një gjë të tillë. Spanja, Greqia, Rumania, Qipro dhe Sllovakia ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Në tekstin e raportit po ashtu përhëndet edhe aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE. Aty, po ashtu, mirëpritet përmbyllja e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën. Të gjitha këto porosi janë pjesë e rezolutës së propozuar dhe u dëgjuan nga shumë deputetë gjatë debatit që u zhvillua të martën mbrëma në seancën plenare të Kuvendit.

Raportuesja për Kosovën, Viola von Cramon, e cila e ka përpiluar tekstin e propozuar, është shprehur e kënaqur për përmbylljen e procesit të

liberalizimit të vizave. “Që nga viti 2019 unë përpiloja raporte për Kosovën duke shprehur vazhdimisht shpresën se do të sigurohet lëvizja e lirë. Tani mund të them se Evropa më në fund i hapi dyert edhe për Kosovën”, tha ajo gjatë debatit.

Në Rezolutën për Serbinë është shprehur keqardhje për mospërshtatjen e qëndrimeve të këtij vendi në politikën e jashtme të BE-së, sidomos sa iu përket sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë. Gjatë debatit për Serbinë pati shumë deputetë që kërkuan nga Beogradi që të shprehet qartë rreth aspiratave për integritet në BE dhe që këtë orientim ta dëshmojë duke mbështetur edhe sanksionet ndaj Rusisë. U dëgjua nga disa deputetë që Serbia po e bën të kundërtën, se në vend që ta rrisë përshtatjen me qëndrimet e BE-së në politikën e jashtme, po e zvogëlon atë.

Deputetja kroate Zheljana Zovko nënvizoi se nga 65 për qind që ka

qenë vitin e kaluar, përshtatja e Serbisë me politikën e jashtme të bllokut evropian ka rënë në 45 për qind.

Sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë - që ndërmjetësohet nga BE-ja - gjatë debatit, raportuesja për Kosovën, Viola von Cramon, kërkoi që palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet dhe që procesi i normalizimit të vizave ta përfshijë njohjen e ndërsjellë.

Ajo, po ashtu, kërkoi që serbët në veri të Kosovës të kthehen në institucione.

Serbët në katër komunat në veri, të banuara me shumicë serbe, u larguan nga institucionet e Kosovës në fund të vitit të kaluar, në shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë së Kosovës që kërkonte reregjistrimin në targa të ligjshme të Kosovës të makinave që bartnin targa ilegale serbe.

Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - ka thënë se kusht për kthimin e serbëve në institucione është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, por edhe tërheqja e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu i shtetit.

Ndryshe, rezolutat e Parlamentit Evropian kanë një rëndësi politike, por ato nuk janë obliguese për vendet anëtare.

Varheli: Propozimi i ekipit menaxhues, pikënisje në diskutimet për Asociacionin

Komisionari evropian për çështje të zgjerimit dhe fqinjësisë, Oliver Varheli, ka thënë se draft-propozimi i ekipit menaxhues duhet të jetë pikënisje në diskutimet për themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Draft-statuti për Asociacionin është prezantuar më 2 maj në Bruksel në kuadër të takimit të nivelit të lartë në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Dokumenti është përpiluar nga një ekip menaxhues, i përbërë prej katër pjesëtarëve të komunitetit serb.

Ky ekip është shkarkuar një ditë më vonë nga autoritetet e Kosovës.

BE-ja ka thënë se ky vendim është në kundërshtim me “frymën dhe tekstin e marrëveshjeve”.

Në debatin për Kosovën, të mbajtur të martën në Parlamentin Evropian, Varheli ka thënë se krijimi i Asociacionit është obligim që del nga marrëveshjet e dialogut. “Duhet të zbatohen të gjitha obligimet nga dialogu, pa vonesa dhe pa kushte, përfshirë”

Kurti viziton Drejtorinë e themeluar për Hetimin e Krimeve të Luftës

PRISHTINË, 10 MAJ - Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë nuk parashkruhen e as nuk vjetrohën asnjëherë. Kriminelët e luftës dhe urdhërdhënësit e tyre duhen nxjerrë para drejtësisë. Serbia duhet mbajtur përgjegjëse për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin në Kosovë kështu ka thënë kryeministri Albin Kurti, i cili sot, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë vizituar Drejtorinë e posathemeluar për Hetimin e Krimeve të Luftës, e cila në të kaluarën ka qenë në nivel sektori. Sipas strukturës së re organizative, drejtoria parashihet të ketë 41 zyrtarë hetues. U vlerësua struktura e re organizative e miratuar e Policisë së Kosovës, me të cilën ky sektor, që ka vepruar me gjithsej 19 zyrtarë hetues, është ngritur në nivel të drejtësisë, dhe në nivelin hierarkik dhe funksional është lidhur drejtpërdrejt me Departamentin Qendror të Hetimeve. "Nuk ka më

prioritet se e vërteta dhe drejtësia për krimet e kryera gjatë luftës, jo veç për këtë brez, por edhe për brezat e ardhshëm", ka thënë Kurti.

Duke i falënderuar për punën dhe angazhimin, Kurti ofroi mbështetjen e plotë për drejtorinë e re.

Kryeministri Kurti veçoi rëndësinë e zbatimit të ligjit për gjykimin në mungesë si dhe Ligjin për themelimin e Institutit për krimet e kryera gjatë luftës, të cilin qeveria e ka dërguar për miratim në Kuvend.

Duke folur për drejtësi për viktimat dhe shoqërinë lidhur me krimet e dhunës seksuale, të përdorur si armë lufte në Kosovë, kryeministri tha se duhet shtuar angazhimi i përbashkët për tejkalimin e pengesave drejt rritjes së numrit të dënimeve nga gjykatat në Kosovë.

Ai theksoi rëndësinë e adoptimit të deklaratës për personat e zhdukur, me të cilën, pas mohimit 24-vjeçar, Serbia pranon krimin e zhdukjes me forcë gjatë luftës



në Kosovë. Kurti veçoi dakordimin për hapje të arkivave nga Serbia, pasi zhdukjet me forcë gjatë luftës ishin krime të kryera nga shteti i Serbisë, pjesë e projektit gjenocidal për shfarosjen e shqiptarëve, "Patkoi".

Po ashtu, theksoi dakordimin për t'i përdorur të dhënat

satelitore, LIDAR dhe teknologji të tjera në zbulimin e varrezave masive potenciale në territorin e Serbisë.

Në takimin e përbashkët me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës, Gazmend Hoxha, drejtorin e Drejtësisë për Hetimin e Krimeve të Luftës, të emëruar së fundmi,

Bashkim Spahiu, hetuesit dhe zyrtarët e kësaj drejtorie, u ritheksua zotimi i qeverisë për të mos reshtur së kërkuari drejtësi për krimet e luftës.

Përderisa që nga 11 maji do të fillojnë punën 15 hetues të rinj, procesi i rekrutimit do të vijojë deri në plotësimin e zyrtarëve të planifikuar me strukturë, pra 41 sosh.

Ministrja Haxhiu pret rezultate brenda afateve të përcaktuara për reformën në drejtësi



PRISHTINË, 10 MAJ - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka marrë pjesë të mërkurën në takimin e parë të grupeve punuese për reformën në drejtësi, në të cilin takim, përveç anëtarëve të grupeve punuese, ishin përfaqësues nga KGJK-ja dhe KPK-ja dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Në këtë takim njoftues ministrja Haxhiu diskutoi për rëndësinë që ka ky bashkëpunim ndër-institucional veçmas në kuadër të reformës në drejtësi. Ministrja Haxhiu e cilësoi të vlefshëm këtë takim të parë, i cili do të ketë një dinamikë të

lartë të punës dhe për të cilin priten rezultate brenda afateve të përcaktuara.

Takimi pati për qëllim të orientojë dhe dakordojë edhe afatet optimale dhe fillimin e punës.

Po ashtu, ministrja Haxhiu vlerësoi mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë në këtë iniciativë si BE, OPDAT, INL, USAID, KiE, Ambasada Britanike, OSBE, EUKOJUST, EULEX, si dhe njoftoi gjithashtu për përfshirjen e shoqërisë civile në këtë reformë, sipas afateve në fazat e parapara.

Gjithashtu, zëvendëskryesuesit nga KGJK-ja dhe KPK-ja, respektivisht Qerim Ademaj dhe Veton Shabani, shprehën gatishmërinë e plotë për angazhim të vazhdueshëm përgjatë gjithë procesit.

Pjesë e kësaj nisme reformuese do të jenë gjashtë grupe punuese.

Kjo reformë është pjesë e zotimeve që dalin nga Deklarata e përbashkët e zotimit e nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial, Gjykata Supreme dhe Zyra e Prokurorit të Shtetit.

edhe atë nga marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015 për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Siç ka nënvizuar përfaqësuesi i posaçëm për dialog [Miroslav Lajçak], draft-propozimi i prezantuar në takimin e fundit nga ekipi menaxhues është pikënisje për diskutimet e mëtejme për themelimin e Asociacionit".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se draft-statuti i prezantuar është "fundamentalisht i papajtuashëm me kushtetutshmërinë" e vendit. Si përgjigje, ai e ka prezantuar më pas një draft-vizion që, sipas tij, rregullon çështjen e komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Në këtë dokument të Kurtit thuhet, mes të tjerash, se ai do t'u ofrojë mundësi pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë për të

promovuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre përmes "kornizës së vetëmenaxhimit", kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me Qeverinë e Kosovës, si dhe mundësi për t'u financuar nga Kosova dhe vende të tjera, përfshirë edhe Serbinë.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013, më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria aktuale e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Përgjatë debatit në Parlamentin Evropian, Varheli ka thënë se Komisioni Evropian e mirëpret

vendimin për liberalizim të vizave për Kosovën.

Institucionet e BE-së kanë marrë vendim që shtetasit e Kosovës të mund të udhëtojnë pa viza në vendet e Zonës Schengen prej 1 janarit të vitit 2024. "Qeveria e Kosovës ka marrë pozicion të qartë sa i përket agresionit rus ndaj Ukrainës dhe ne e mirëpresim këtë. Kosova duhet ta përmirësojë kornizën ligjore për vazhdimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë edhe konfiskimin e pasurisë së krijuar në mënyrë ilegale".

Sipas tij, gjyqësori ende nuk është sa duhet efikas dhe ka ndërhyrje të panevojshme politike.

Mes të tjerash, Varheli ka shprehur gatishmërinë për ta vazhduar ndihmën për Kosovën në sektorin e energjisë.



QIRINJTË E DYFYTYRËSISË!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Krimi pa adresë në Kosovë: Kohë më parë ndodhën dy krime të tmerrshme në Serbi me ç'rast një fëmijë 13 vjeçar vrau në një shkollë fillore në Beograd 5 nxënës dhe 3 të rritur kurse 48 orë më vonë një 21-vjeçar në Mlladenovc vrau 8 persona dhe plagosi 14 të tjerë. Në dy raste që nuk ndërliidhen me njëri - tjetrin humbën jetën njerëz dhe fëmijë të pafajshëm. Reagimi ishte i madh në Serbi ku keqpërdorej edhe politikisht, si nga pozita ashtu edhe nga opozita sikur që kishte përkrahje solidariteti me familjet e viktimave edhe nga shtetet dhe vendet tjera që duhet dhe është solidarizim nga pozitat njerëzore. Në Kosovë ishte një reagim i menjëhershëm duke ndezur qirinjtë para Teatrit Kombëtar që, në një mënyrë është shndërruar në "Mur Vajtimit", sikur ai në Jerusalem. Ndezja e qirinjeve është shndërruar në një ritual ku reagohej sipas një automatizmi, jo gjithëherë i sinqertë, madje, më së paku i sinqertë për përfitime mediatike dhe materiale, pa asnjë dyshim. Ndezësit e qirinjeve thuaja janë persona të njëjtë dhe aspak nuk është e vështirë të parashikohet kur dhe si do t'i ndezin qirinjtë. Në Kosovë afërsisht 2000 fëmijë janë ekzekutuar nga policët, paramilitarët dhe ushtarët e Serbisë apo e kanë humbur jetën shkaku i pamundësisë t'iu ofrohet kujdesi shëndetësor apo mungesë të ushqimit sikur edhe kushteve të rënda klimatike. Fëmijët shqiptarë janë ekzekutuar thuaja në të gjitha vrasjet në masë e që gjithmonë

janë mohuar nga regjimi serb pjesë aktive e të cilit në kohën kur u masakruan këta fëmijë ishin edhe Aleksandar Vuçiqi dhe Ivica Daçiq, midis shumë të tjerëve. Kur KMDLNj e pati bërë publike fotografinë e një foshnje të ekzekutuar të familjes Delijaj, regjimi i Serbisë që për shef të informimit e kishte Aleksandar Vuçiqin doli publikisht me deklaratë se shqiptarët e kanë veshur një kukull me rroba të foshnjes për ta paraqitur si vrasje të fëmijëve. Nuk kishte asgjë më çnjerëzore se kjo deklaratë e një personi që falsifikonte faturat e krimet siç e bënte Aleksandar Vuçiqi në atë kohë dhe siç e bënë edhe sot! As Serbia e as udhëheqësit më të lartë politikë dhe ushtarakë të Serbisë asnjëherë nuk i pranuan këto krime madje i mohuan edhe masakrat si ajo e Reçakut dhe të tjera. Disa prej këtyre masakrave ua veshën bombardimeve të NATO-s. Nëse gjatë luftës dhe menjëherë pas përfundimit të luftës hezitonin t'i pranonin këto krime, sidomos ndaj fëmijëve shqiptarë, tash, 24 vite pasi lufta ka përfunduar dhe kur po bisedohet për normalizim të marrëdhënieve, nuk ka asnjë arsye të mohohen këto krime. Nëse sinqerisht duan të ballafaqohen me të kaluarën dhe të normalizojnë marrëdhëniet me shqiptarët për aq sa është e mundur në këtë fazë të procesit. Para Teatrit Kombëtar kur u ndezën qirinjtë kishte edhe personalitete të larta politike që nuk është se ishin shquar në raste kur kërkohej drejtësi për viktimat e luftës në Kosovë në

përgjithësi dhe fëmijëve, në veçanti. Tash, pushteti i bekuar me të gjitha të mirat që po ua ofron po i nxjerrë në tërë lakuriqësinë e tyre të mungesës së dinjitetit, karakterit dhe përkushtimit duke i shndërruar në zombi të maskuar me një pëlthurë njerëzore. Ashtu siç e kërkon pushteti apo gjakimi që të qëndrohet në pushtet. Nuk vonoi shumë dhe, sipas një automatizmi të akorduar reagan, si qirinjtë të shuar, kryeministri Albin Kurti, presidentja Vojsa Osmani dhe Glauk Konjufca, Çarli Çaplini i Kuvendit të Kosovës. Në rrethana normale reagimi i tyre do të ishte krejtësisht normal kurse, në këto rrethana reagimi i tyre ishte për qëllime politike, i pasinqertë, manipulativ dhe jo i domosdoshëm. Reagimi i tyre ishte për t'iu vardisur ndërkombëtarëve; Lajçakut, Borrellit, Macronit, Sholcit, Eskobarit dhe burokratëve tjerë. Ishte reagim pa shpirt, refleksiv, i pasinqertë dhe për përdorim të jashtëm. Ka munguar vetëm të hapin edhe të pame! Gjë që asnjëherë nuk e kishin bërë për fëmijët shqiptarë të vrarë në luftën e fundit në Kosovës. Dyfytyrësia!

Kur presidenti i Kosovës Hashim Thaçi shkoi në fshatin Staro Gracko dhe u përkul para viktimave civile serbe, qytetarë dhe shtetas të Kosovës që u vranë duke punuar tokat e tyre nga persona të paidentifikuar deri më tani, ndaj presidentit Thaçi filloi një linçim medial dhe politik, vetëm sa nuk e ekzekutuan. Edhe këta që janë

sot në pushtet. Ndërkaq që ishte krejtësisht normale që të nderohen viktimat e pafajshme civile, shtetas të Kosovës të përkatësisë etnike serbe. Po e njëjta situatë ishte me ata që solidarizoheshin me familjet e fëmijëve serbë të fshatit Gorazhdec, qytetarë dhe shtetas të Kosovës që u vranë në rrethana të pasqaruara, pa bërë asnjë faj, nga vrasës të paidentifikuar deri më sot. Zbatim i standardeve të dyfishta ndaj viktimave civile; për të vrarët serbë në Staro Gracko dhe fëmijët serbë në Gorazhdec, nuk kishte reagime sepse nuk përfitohej politikisht kurse për fëmijët dhe personat serbë të vrarë në Serbi e që nuk kanë të bëjnë fare me Kosovën, bartësitë më të lartë të institucioneve po derdhin lotë krokodili, aligatori, kajmani, hardhuce e zhapini. E pabesueshme!

Dyfytyrësia si dukje dhe veprim: U bë lajm dite kërkesa e Qerim Qerimit, i zgjedhur rektor nga establishmenti aktual politik dhe qerimqerimëve tjerë për rikthim të emrit të Universitetit të Prishtinës duke e hedhur në shportë të mbeturinave emrin e Hasan Prishtinës. Sot, të jesh patriot në Kosovë është rrethanë rënduese në të gjitha sferat e jetës. Mbetjet jugosllave dhe serbe, të shndërruara në mumie që ende sillen vërdallë sikur edhe trashigimtarët e tyre biologjikë, nëpër intervista dhe fejsbuka po e sulmojnë emërtimin e këtij Universiteti si diçka që në atë kohë iu ishte imponuar nga politika përmes ish-rektorit Mujë

Rugova në kohën kur në oborrin para rektoratit duartrokisnin gjatë pëprurimit të shtatores së Hasan Prishtinës të cilin, një politikane e rangut të lartë, duke e lexuar fjalën e rastit, në mes të tjerash pati deklaruar se Hasan Prishtina ka qenë shok i ngusht e idealit me Luigj Karakuqin (Gurakuqin, mendoj). Tash, në tërë këtë entusiasmin antikombëtar kundër çdo vlere patriotike, ndoshta, si zgjedhje kompromisi duhet të përcaktohem midis "Mirë Dita, Dobar Dan" apo ta emërtojmë me emrin e ish-rektorit Radoje Papoviçit, të cilit disa i patën shërbyer me zell shfrenues. Sidomos kjo vlenë për jugonostalgjikët dhe serbonostalgjikët! Pse dhe kujt i pengon thjesht emërtimi Universiteti "Hasan Prishtina" përveç këtyre që iu pengon Adem Jashari, Adem Demaçi, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Rexhep Malaj e Nuhi Berisha, Bahri dhe Fahri Fazliu, Afrim Zhitia dhe Zahir Pajazit, Xhon Serreçi dhe Marie Shllaku dhe të gjithë patriotët tjerë. Kohë të vështira janë mbi Kosovën dhe shqiptarët, dënohem nëse i përkrahim heronjtë që na çliruan e që po mbahen si pengje në Gjykatën Raciste në Hagë dhe lavdërohem nëse themi "Mirë Dita, Dobar Dan". Milaim Zeka e pati mirë një ditë kur tha se personalitetet e shquara politike dhe kombëtare shqiptare, më mirë të mos lenin fare pasardhës. Së paku nuk do të detyrohen të rrotulloheshin në varr për poshtërsitë dhe të pabërat e mendermethënë pasardhësve të tyre!

Kush dëshiron ta heq emrin Hasan Prishtina, simbolin që mishëron luftën për pavarësi kombëtare?



Bardhyl MAHMUTI,
politolog

Përpjekjet që nëpërmjet ndryshimeve të statutit të

Universitetit të Prishtinës t'i hiqet "Hasan Prishtina" nga emërtimi i tij me arsyetim se gjoja krijon pasaktësi për shkak se një universitet i krijuar nga strukturat kriminale të instaluar në qytetin e Mitrovicës nga Slllobodan Millosheviqi mban emrin "Universiteti i Prishtinës" është absurdi më i madh që ka prodhuar ndonjëherë udhëheqja e institucionit më të lartë arsimorë në Kosovë.

Në vend të mobilizimit të gjithanshëm të institucioneve shtetërore dhe universitare për delegjtimimin e plotë të universitetit ilegal në veri të vendit, del propozimi që nga emërtimi i Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina të hiqet emri i njërës nga figurat më të shquara të historisë kombëtare shqiptare, që është sinonim i shtetësisë sonë. Nuk e di se ku i ka rrënjët kjo ide e mbrapsht dhe nuk dëshiroj të

lëshohem në hipoteza. Mirëpo, nëse lëshojmë pe ndaj iniciativës që të heqim emrin e Hasan Prishtinës, personalitetit kombëtar që mishëron luftën për pavarësi të trojeve shqiptare, nuk duhet të habitemi kur njerëz të të njëjtës logjikë të propozojnë heqjen nga Kushtetuta e Kosovës të fjalës pavarësi, me arsyetim se gjoja "krijon pasaktësi për shkak se në Preambulën e Kushtetutës së Serbisë, Kosova është pjesë e atij

shteti"! Është koha të zhvishet qëllimi i vërtetë i nismës së lartpërmendur dhe të pamundësohet realizimi i saj! Unë mbështes Fondacionin "Hasan Prishtina", kuadrin pedagogjik dhe studentët e këtij universiteti që kanë dalë kundër iniciativës tejet të dëmshme dhe shumë të rrezikshme për heqjen e emrit të Hasan Prishtinës nga emërtimi i Universitetit të Prishtinës.

Sondazhi i Pyper-it: Inflacioni, shqetësimi kryesor i qytetarëve në Kosovë



PRISHTINË, 10 MAJ - Pyper dhe Valicon në një sondazh të realizuar gjatë muajit shkurt kanë gjetur se rritja e çmimeve vazhdon të jetë shqetësimi kryesor i qytetarëve në Kosovë. Sipas këtij hulumtimi, del se Kosova po përjeton më pak përmirësim financiar sesa vendet e tjera të rajonit. "Kosova po përjeton më pak përmirësim financiar sesa vendet e tjera. Të anketuarit po

blejnë më pak se gjashtë muaj më parë. Inflacioni ka pasur ndikim të madh në Kosovë, ku 73 për qind e të anketuarve e kanë përmendur atë si shqetësimin kryesor", thekson hulumtimi, raporton "Telegrafi". Po ashtu, qytetarët në vend situatën aktuale po e perceptojnë si të pashpresë, kaotike dhe të pakëndshme. "Indeksi i Normalitetit në Kosovë ka dalë të

jetë më i ulëti që tregon se kosovarët e perceptojnë situatën aktuale si të pashpresë, kaotike dhe të pakëndshme", shton raporti. Aty thuhet se kosovarët kanë më së shumti besim në qeverinë e tyre krahasuar me disa vende të Ballkanit. "Kosovarët kanë më së shumti besim në qeverinë e tyre në krahasim me Slloveninë, Kroacinë, Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën", përfundon Pyper.

Indeksi i Normalitetit, që mat situatën aktuale, ndryshon nga -44 në Kosovë deri në 1 në Kroaci. Bosnja e Hercegovina, Serbia dhe Sllovenia kishin pikë negative, tregues se respondentët në ato vende po përjetojnë një nivel pesimizmi dhe kaosi në jetën e tyre. Indeksi i Statusit Financiar tregoi një trend të ngjashëm. Serbia kishte nivelin më të ulët të indeksit

me -47, ndjekur nga Kosova me -34 dhe Bosnjë-Hercegovina me -32 pikë. Niveli i Konsumit ka shënuar po ashtu zvogëlim në të pesë shtetet, ku Serbia kishte nivelin më të ulët me -66 dhe Kosova me -64 pikë. Përgjigjja më e zakonshme ndaj këtyre ndryshimeve ishte se respondentët po blinin më pak produkte sesa gjashtë muaj më parë.

Në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale për tre muaj u kryen 561 operacione

PRISHTINË, 10 MAJ - Në tremujorin e parë të vitit 2023, në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale të Qendrës Klinike dhe Universitare të

Kosovës janë kryer gjithsej 561 operacione nga kirurgët abdominalë, në bashkëpunim me anesteziologët nga Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit

Intensiv. Në ambulanca specialistike janë kryer gjithsej 1 279 vizita mjekësore. Stafi mjekësor i asistuar edhe

nga infermierët, po ashtu ka kryer edhe 58 kolonoskopi, 129 ERCP- teknike endoskopike mini-invasive dhe 48 gastroskopi.



Mungesa e punëtorëve i detyron bujqit t'i zvogëlojnë të mbjellat



PRISHTINË, 10 MAJ - Rritja e temperaturave në fillim të muajit maj i shtyu fermerët në Kosovë të nxitojnë për mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore por, qysh në fillim, shumë prej tyre u përballën me mungesë punëtorësh.

Zenë Haradinajn, nga fshati Stanoc i Epërm i Vushtrrisë, e përcolli fati i njëjtë. Ai thotë se u vonua me mbjelljen e specave, domateve dhe trangujve në serën e tij nga pamundësia e gjetjes së dy punëtorëve sa i duhen aktualisht. “Kam qenë shumë i zënë me mbjelljen e misrit dhe grurit. Në mungesë të punëtorëve jam vonuar shumë për mbjelljen e serës... por, sido që të jetë, do ta mbjell vetë”, thotë Haradinaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai tregon se këtë vit i ka shkuar në mendje të mos e mbjellë serën pasi, siç thotë, me të njëjtën situatë është përballur edhe vitin e kaluar. “Mua më duhen rregullisht dy [punëtorë], por shpeshherë edhe më shumë. Në kohën e vjeljeve më duhen më shumë se katër, por kush ishte për punë, ka ikur [jashtë vendit], e kush është këtu, merret me punë të tjera”, thotë ai.

Pavarësisht prej vështirësive për t'i kryer të gjitha punët me anëtarët e ngushtë të familjes, Haradinaj thotë se këtë vit, përveç perimeve, ka

vendosur të mbjellë edhe 23 hektarë misër dhe 12 hektarë grurë.

Kush punoi, iku

Tahir Tahiri, udhëheqës i Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës, thotë se Haradinaj nuk është i vetmi fermer i cili ka telashe të tilla. Ai thotë se sektori i bujqësisë gjatë tre vjetëve të fundit është përballur vazhdimisht me ikjen e fuqisë punëtore, por jo vetëm. “Janë larguar nga Kosova shumë të rinj në tre vjetët e fundit jo vetëm punëtorë, por edhe pronarë e udhëheqës fermash, të cilët janë dekurajuar qoftë për shkak të dështimeve apo edhe mungesës së mbështetjes”, thotë Tahiri.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2021 mbi 42 000 banorë janë larguar nga Kosova, kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Në vitin 2020 - kur ka shpërthyer pandemia e koronavirusit - nga Kosova kanë emigruar mbi 8 000 veta; më 2019 mbi 34 000; më 2018 mbi 28 000.

Arsyet e migrimit janë të llojllojshme, ndërsa në mesin e tyre bën pjesë edhe punësimi. Shifrat e migrimit janë shqetësuese për sektorin e bujqësisë, thotë Tahiri, i cili parashikon vështirësi edhe më të mëdha për fermerët gjatë muajve dhe viteve në vijim. “Kur vjen puna te vjeljet, për shembull te specat, domatet,

trangujt, patatet, mjedrat, ka shumë probleme, sepse në vllugun e vjeljeve duhet shumë fuqi punëtore për t'i vjelë ato në kohën e caktuar, ndryshe prishen dhe nuk shiten”, thotë Tahiri.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), sipërfaqja e mbjellë me perime në Kosovë gjatë vitit 2021 ka përfshirë një hapësirë prej 19.399 hektarësh, ku janë prodhuar gjithsej 282 734 tonë perime.

Fermerët heqin dorë nga prodhimi i perimeve

Tahiri paralajmëron se sasia e prodhimit të perimeve mund të bjerë këtë vit për shkak se fermerët kanë filluar ta kufizojnë sipërfaqen e mbjellë me to. “Po shkohet drejt reduktimit të sipërfaqeve të mbjella pikërisht për shkak të mungesës së fuqisë punëtore. Pra, fermerët po mbjellin misër dhe grurë, pasi procesi është i mekanizuar dhe një person mund t'i kryejë të gjitha punët në çfarëdo sipërfaqeje”, thotë ai.

Reduktimi i sipërfaqes së punuar është duke ndodhur tashmë në komunën e Rahovecit, konfirmon drejtori i Bujqësisë në këtë komunë, Berat Duraku. Ai thotë se fermerët janë duke hequr dorë nga prodhimi i perimeve për shkak

të mungesës së fuqisë punëtore. “Për shkak të mungesës së punëtorëve, shumë fermerë tanë kanë kaluar në prodhimin e drithërave. Do të thotë, na janë rritur sipërfaqet me drithëra dhe na ka rënë perimekultura”, thotë Duraku për “Radion Evropa e Lirë”.

Krahas perimekulturës, shton ai, janë duke rënë edhe vreshtaria dhe sektorë të tjerë të prodhimit. “Rahoveci është i njohur për dy sektorë: perimtaria dhe vreshtaria. Vreshtaria është ajo që ka mbetur, që është e mbjellë dhe që do kujdes, ndonëse edhe vreshtaria ka filluar të bjerë në sipërfaqe për shkak se nuk po ripërtërihen plantacionet e vjetruara. Njëjtë edhe perimtaria është duke rënë për shkak të ikjes së të rinjve”, thotë Duraku.

Si Duraku ashtu edhe Tahiri thotë se reduktimi i prodhimit nëpër fermat e Kosovës do t'i hapë rrugë rritjes së importit. Kosova prej vitesh përballlet me deficit të lartë tregtar - duke importuar më shumë dhe eksportuar më pak - gjë që, siç thonë ekspertët, e pengon edhe rritjen ekonomike.

Aktualisht institucionet qendrore e as komunale nuk duket se kanë ndonjë strategji se si t'i ndihmojnë fermerët në përballje me mungesën e fuqisë punëtore.

“Radio Evropa Lirë” e ka pyetur Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nëse ka ndonjë plan në këtë drejtim, por deri në publikimin e këtij teksti

ky institucion nuk ka kthyer përgjigje.

Sektori i bujqësisë në dy vjetët e fundit është goditur edhe nga rritja e çmimit të naftës. Megjithatë, këtë vit Qeveria e Kosovës ka filluar ta subvencionojë naftën për bujqit e regjistruar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë të rregullt.

Në një postim të mëhershëm në rrjetet sociale, ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka shkruar se me çmimin aktual të naftës, “një bujk që ushtron aktivitetin e tij në mënyrë të rregullt, i regjistruar si subjekt formal, paguan vetëm 0.66 centë për 1 litër naftë, pasi përfiton 0.36 centë subvencionim në vlerë të akcizës dhe mund të përfitojë nga rimbursimi i TVSh-së”.

Sipas hulumtimeve të bëra nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, vështirësi në gjetjen e punëtorëve, përveç sektorit të bujqësisë, ka edhe ai i gastronomisë dhe i ndërtimit. Interesimi i qytetarëve për të punuar, sidomos në sektorin privat, ka rënë për disa arsye që, sipas Inspektoratit të Punës, lidhen me mungesën e kontratës, punën në fundjavë, mospagesën e orëve shtesë, pagën e ulët e të tjera.

Paga minimale në Kosovë nga viti 2011 është 130 euro për personat nën moshën 35 vjeç dhe 170 euro për ata mbi 35 vjeç. Paga mesatare bruto për vitin 2021, sipas ASK-së, ka qenë 484 euro.

Teoria e mendjes: Ç'mund të na mësojnë Shahu dhe shpërndarësit e drogës, për MANIPULIMIN



Tonny THOMSON

Teoria e mendjes është aftësia që ne të gjithë kemi për t'i parë gjërat nga këndvështrimi i tjetrit. Është thelbësore në të gjitha ndërveprimet tona. Një studim i ri nga Shkolla e Mjekësisë Mount Sinai tregon se sa shumë e përdorim këtë kur bindim të tjerët. Manipulimi i të tjerëve shfrytëzon një pjesë të trurit tonë të përdorur shpesh në lojëra si shahu. Ndoshta të qenit më i mirë në njërin të bën më të mirë në tjetrin?

Takticienët më të mëdhenj të botës janë ata që mendojnë përpara. Mjeshtrat e shahut, gjeneralët e famshëm, liderët e mëdhenj botërorë dhe donët e mafias ndajnë të gjithë një aftësi: Ata janë të gjithë shumë më tepër hapa përpara se rivalët e tyre. Secili prej nesh ka aftësinë për të menduar përpara. Në fakt, është e vështirë të imagjinohet një njeri funksional që nuk ka menduar përpara të paktën disa herë. Ju ndoshta keni planifikuar se çfarë të bëni sonte dhe me siguri e dini rrugën që do të bëni për të shkuar në shtëpi. Të menduarit përpara është një shenjë dalluese e inteligjencës.

Pa të, ne jemi thjesht sklevër të instinkteve dhe reflekseve tona – paksa si një bimë apo një fëmijë. Po ç'mund të themi për rolin e të menduarit përpara kur kemi të bëjmë me të tjerët? Është diçka e trajtuar në një studim të fundit nga Shkolla e Mjekësisë Mount Sinai. Tregon se sa larg mendojmë kur ndërveprojmë – dhe manipulojmë – me njerëz të tjerë.

Një teori e mendjes

Problemi me botën është se ajo është plot me njerëz të tjerë. Ndryshe nga ju (sigurisht!), ata njerëz janë shpesh të paparashikueshëm, të pavarur dhe jashtëzakonisht të palexueshëm. Nuk ka asnjë mënyrë që ne të futemi në kokën e tyre për të ditur se çfarë po mendojnë ose çfarë do të bëjnë. Por duke pasur parasysh se njerëzit janë një specie shoqërore, nuk është çudi që kemi zhvilluar mënyra për të llogaritur se çfarë mund të mendojnë njerëzit e tjerë. Kjo njihet si “teoria e mendjes”, aftësia që shumica prej nesh kanë për ta vënë veten në vendin e dikujt tjetër. Në shkallë të ndryshme, njerëzit me autizëm mund të mos e kenë këtë aftësi.)

Teoria e mendjes është diçka që ne e mësojmë ndërsa rritemi. Fëmijët do të mësojnë se njerëzit e tjerë kanë jetën e tyre mendore – dëshirat e tyre, emocionet, e kështu me radhë – që rreth 15 muajsh, por ata janë ende jo shumë të zotë në kompensimin dhe përshtatjen me këtë për një farë kohe. Për shembull, nëse një dyvjeçar sheh një person tjetër në ankth, ai do të kërkojë t'a ndihmojë duke i dhënë lodrën ose gjënë e preferuar. Ata e kuptojnë se dikush ka ndjenjat e veta, por nuk mund të kalojnë përtej kësaj për të menduar se çfarë mund të dëshirojë personi tjetër. Shumica e njerëzve kanë një teori jashtëzakonisht të sofistikuar të mendjes. Ja një shembull: Le të themi se unë dhe ti po flasim për diçka, dhe ti më sheh mua duke parë orën. Cilat supozime apo mendime kalojnë tani nëpër kokën tënde? A mos po më mërzit? A duhet të jem diku? A ka një merimangë tek ora? Në fakt, njerëzit që “mendojnë tepër” gjërat shpesh humbasin dhe bllokohen në këtë lojë të përpunuar të teorisë spekulative të mendjes. Ashtu si me shumë gjëra, një zakon i dobishëm i trurit bëhet toksikur e çon shumë larg.

Gjithmonë dy hapa përpara

Ajo që studimi i fundit shton diskutimit është shqetësimi se sa shumë e përdorim në këtë teori të mendjes kur përpiqemi të bindim ose manipulojmë të tjerët. Ekipi nga Mount Sinai kishte 48 pjesëmarrës të ulur në një skaner truri dhe që luanin një lojë “lojë ultimatum”. Në thelb, ata u ndanë në ekipe dhe iu tha të ndajnë 20 dollarë me njëri-tjetrin. Në një version të lojës, nuk kishte asnjë rregull. Ata mund të bënin pazare, të negocionin, të manipulonin sa të donin.

Studimi zbuloi dy gjëra:

Së pari, pas një analize llogaritëse të të gjitha lojërave të përfunduara, ata zbuluan se rezultatet ishin ato që priten nga njerëzit që mendonin “dy, tre ose katër hapa përpara” nga të tjerët. Me fjalë të tjera, nëse njerëzit do të mendonin vetëm një hap përpara, ose vetëm bazuar tek reagimi, rezultatet do të dukeshin krejtësisht të ndryshme. Së dyti, skanimet e trurit zbuluan se zgjedhjet e bëra gjatë negociatave u shoqëruan me aktivitet në korteksionin parabolle ventromedial. Kjo është e njëjta pjesë e trurit që përdoret në

shumicën e vendimeve që mendohe përpara. Pra, të paktën në aspektin neurofizilogjik, manipulimi i të tjerëve është pothuajse i njëjtë me çdo komplot tjetër.

Çdo ndërveprim është një lojë shahu

Ka një skenë të paharrueshme tek “The Wire”, ku D'Angelo përdor botën reale të tregtisë së drogës për të shpjeguar rregullat e shahut. Funksionon mirë, dhe tani mund ta dimë pse. Kur ne përpiqemi të lëkundim ose manipulojmë të tjerët, truri ynë aktivizohet në të njëjtën mënyrë si kur luajmë shah.

Çdo ndërveprim shoqëror është një lojë shahu, përpjekja për të hyrë brenda kokës së dikujt për të lundruar atë që ata po mendojnë ose çfarë do të bëjnë. Është fatkeqësia e marrëdhënieve dhe burimi i shumë konflikteve. Pra, po sikur të mund të jemi më të mirë në të? Ne e dimë se shahu na jep një mori përfitimesh, por ndoshta mund të shtojmë “ju bën më të mirë në rrugën tuaj” në jetë? Është koha për të hequr pluhurin nga tabela e shahut, vërtetë.

Jonny Thomson jep filozofi në Oksford. / Big Think – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sonte beteja e tretë mes Trepçës dhe Pejës

MITROVICË, 10 MAJ - Super sfidat e "play-off"-it të finales vazhdojnë të enjten mbrëma në "Minatori" të Mitrovicës. Atmosfera pritët të jetë e jashtëzakonshme, ashtu siç ka qenë në përballjet që janë zhvilluar në Mitrovicë këtë edicion, sidomos në garat shtesë. Trepça dhe Peja ndeshen me skuadrat që synojnë të kalojnë në epërsi

2:1. Ndeshjen e parë e fituan mitrovicasit 94:86, kurse pejanët u kundërpërgjigjën në takimin e dytë 107:79, duke shënuar një rën nga fitoret më bindëse në këtë edicion, e kjo pikërisht erdhi në finalen e dytë. "Xehetarët" për të depërtuar në finale eliminuan Bashkimin dhe Sigal Prishtinën, ndërsa Peja fitoi duelin verdhezi kundër

Golden Eagle Yllit. Përballjet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritët edhe të enjten mbrëma (sonte) nga ora 20:00. Kujtojmë se Trepça për herë të fundit ishte shpallur kampione më 2012, ndërsa Peja më 2013. Mitrovicasit fituan Kupën e këtij edicioni, ndërsa pejanët ishin finalistë të Ligës Ballkanike.



Interi tregon forcën ndaj Milanit, afër kalimit në finale

MILANO, 10 MAJ - Interi tregon forcën në gjysmëfinalen e parë të derbit ndaj Milanit dhe hedh një hap drejt finales në Ligën e Kampioneve. Skuadra zikaltër fitoi pastër 2-0 në një "San Siro", i cili ishte i mbushur më shumë nga fansat kuqezi. Fillimi i ndeshjes ishte fantastik për Interin që do të gjente dy golat, ndërkohë që Milani ishte në kaos total. Në minutën e 8-të, pas një goditje nga këndi, Edin Dzeko me një veprim shumë të bukur në zonë ndaj Calabria's arrin ta dërgojë topin në trekëndëshin e portës së Maignan. Tre minuta më pas, Mkhitaryan



përfiton nga përgjumja e mbrojtjes së Milanit duke realizuar golin e dytë përballë

portierit francez, i cili sërish nuk kishte mundësi reagimi. Kuqezinjtë e kishin të vështirë

për të gjetur një reagim, teksa skuadra zikaltër vijonte të ishte rrezik konstant me Dimarcon

dhe Dumfries. Mkhitarjan do të godiste shtyllën pak minuta më pas, duke trembur dhe më keq Milanin e përgjumur. Në pjesën e dytë do të vinte dhe rasti më i mirë për ekipin e Piolit, por një goditje e Tonalit në hyrje të zonës do të stampohej në shtyllë dhe më pas do të shkonte jashtë kuadrantit. Ndeshja e kthimit do të luhet një javë me pas, të martën, në të njëjtën stadium, por me Interin që vjen dukshëm më e favorizuar, ndërkohë që tifozët e Milanit shpresojnë në një rikthim të mundshëm të Leaos nga dëmtimi.

Largohet Engin Gençoğlu, 'Trepça' drejtohet nga Ilir Selmani

MITROVICA, 10 MAJ - Largimi i Engin Gençoğlu nga KB Trepça tashmë është zyrtar, pasi klubi nga Mitrovica ka konfirmuar ndarjen me trajnerin turk. Trepça e ka falënderuar Gençoğlun për kontributin e madh që ka dhënë në klub, derisa ka njoftuar se skuadra deri në fund të plejofit do të drejtohet nga Ilir Selmani. "Klubi i Basketbollit 'Trepça' njofton se me marrëveshje të dyanshme ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Engin Gençoğlu. Skuadrën deri në fund të plejofit e drejton Ilir Selmani, që deri më tani ishte



në shtabin teknik. Klubi e falënderon Gençoğlun për kontributin e dhënë në skuadrën tonë. Bashkë kemi fituar Kupën e Kosovës dhe kemi arritur në finale të plejofit.

Të gjithë në klub janë të përkushtuar që skuadra ta shfaqë më të mirën në ndeshjen e nesërme ndaj Pejës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Trepçës.

S'ka medalje as për Laura Fazliun

Doha, 10 maj - Kosova ka mbetur pa medalje në Kampionatin Botëror të Xhudos, pasi edhe xhudistja Laura Fazliu nuk ka arritur të rrëmbejë medalje. Ajo është mposhtur edhe në luftën e repesazhit në kërkim të medaljes së bronzit. Laura u dorëzua përballë hungarezes Szofi Ozbas në kategorinë deri në 63 kilogramë, kurse arriti të shkonte deri në çerekfinale, por u ndal aty duke pësuar dy humbje radhazi. Krahas humbjes nga hungarezja për medalje të bronzit, Fazliu u mposht edhe nga sllovenia Andreja Levski në çerekfinale. Paraprakisht, Laura në rrethin e parë e eliminoi garuesen Nadia



Matchiko Guimendego, ndërsa në atë të dytë ishte më e mirë se Iva Obertan, e në atë të tretë e mposhti brazilianen Ketleyn Quadros. Në këtë ngjarje garuan edhe kampionet olimpike Nora Gjakova e Distria Krasniqi, si dhe garuesit e tjerë Akil Gjakova, Erza Muminoviq e Flaka Loxha. Kosovën në këtë Botëror do ta përfaqësojë edhe Loriana Kuka.

Finalja e Kupës së Kosovës për femra zhvillohet më 17 maj

PRISHTINË, 10 MAJ - Ndeshja finale e Kupës së Kosovës për vajza në futboll, ndërmjet EP Hajvalisë dhe Mitrovicës, do të zhvillohet me datën 17 maj (e mërkurë), në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, në orën 17:00. Do të jetë kjo një

përballje mjaft interesante e dy skuadrave më të cilësore në futbollin e vajzave e grave në Kosovë e të cilat janë në garë edhe për titullin e kampionit në Sigal Superligë. Në gjysmëfinale të dyja skuadrat realizuan fitore të lehta: EP

Hajvalia fitoi me rezultat 4:1 kundër Dukagjinit, ndërsa Mitrovica e mundi 16 Qershorin me rezultat 7:1. Këto dy skuadra janë ballafaquar edhe në finalen e vitit të kaluar, ku Mitrovica kishte fituar me rezultat 2:1.



Busquets konfirmon largimin nga Barça: Ka qenë nder, ëndërr dhe krenari të mbroja këtë stemë

Barcelonë, 10 maj - Kapitani i Barcelonës, Sergio Busquets, ka njoftuar edhe zyrtarisht se do të largohet nga klubi në fund të sezonit, duke zgjedhur fjalët më të mira në një video të publikuar në faqen zyrtare. 34-vjeçarit i skadon kontrata në

fund të sezonit dhe ka vendosur të mbyllë një nga karrierat më të lavdishme të Barcelonës në histori, duke fituar gjithçka të mundshme në shumë raste. Në një deklaratë me video të publikuar përmes medieve sociale të klubit,

Busquets shpjegoi se kishte ardhur koha për të thënë lamtumirë, duke i falënderuar të gjithë njerëzit gjatë rrugës që i kanë kaluar kohën në klub. "Do të bëhem tifoz dhe anëtar. Të jesh tifoz i Barcelonës është gjëja më e mirë që ekziston", ka

thënë Busquets. "Ka qenë një nder, një ëndërr dhe një krenari të jem në gjendje të mbroja këtë stemë, por gjithçka ka një pikë përfundimtare. Nuk ka qenë një vendim i lehtë, por ka ardhur koha", ka shtuar Busquets.



Ancelotti: Mund të fitojmë në 'Etihad'. Guardiola: Kam një ide për ndeshjen kthyesë

MADRID, 10 MAJ - Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e ka quajtur të ekuilibruar sfidën e zhvilluar në "Santiago Bernabeu" ndaj Real Madridit (1-1). Tekniku spanjoll më pas ka thënë se finalisti vendoset në Manchester, atje ku e ka të qartë se si duhet të veprojnë për ta ndëshkuar kundërshtarit. "Ndeshje e barabartë. Kur ishim më mirë ne ata shënuan një gol, kur ishin më të mirë ata ne barazuam. Ndonjëherë më dukej si vitin e kaluar. Urime për ekipin tim! Në këto lloj ndeshjesh keni nevojë për lojtarët tuaj më të mirë dhe Edersoni ishte i jashtëzakonshëm. Kyle Walker ishte i jashtëzakonshëm kundër një prej rivalëve më të mirë me të cilët mund të përballësh në mbarë botën. Manchesteri do të jetë si një finale para tifozëve tanë", ka thënë Guardiola. "Jam i kënaqur me një barazim 1-1 ... në vend të humbjes 3-0! Do ta shikojmë lojën përsëri tani. Në disa pjesë ishim mirë. Por, mendoj se mund të kishim kërkuar më shumë gola me më shumë agresivitet. Kam një ide



se çfarë të bëj javën tjetër. Por, më duhet ta shikoj sërish këtë ndeshje", ka shtuar Guardiola. Në anën tjetër Carlo Ancelotti shpreh optimizëm se Real Madridi mund të kualifikohet në finale, an pse barazoi në ndeshjen e parë (1-1). "Parandjenjat janë të mira. Ne luajtëm, luftuam, e planifikuam mirë ndeshjen dhe kemi ndjesi të mira. Rezultati nuk na shpërblen. Në 30 minutat e para ne nuk ishim të shqetësuar, ishim të pozicionuar mirë në mbrojtje dhe prisnim momentin e duhur për të bërë një pasim efektiv. Ndeshja e dytë? Po, ne

mund të fitojmë... Manchester City ka parandjenjën e një rezultati të mirë, po ashtu edhe ne. Ne luajmë jashtë shtëpisë, nuk kemi tifozë, por i kemi në zemër", ka thënë Ancelotti, i cili pati lëvdata edhe për mbrojtësin Rudiger, i cili e ndali në mënyrë të shkëlqyer sulmuesin Haaland. "Rudiger ishte i shkëlqyeshëm. Top performancë. Ishte shumë i mirë. Ai është lojtar me përvojë të madhe, me kualitet të lartë. Nuk ishte lehtë për të, por luajti shumë mirë. Jam shumë i lumtur me Rudigerin", ka shtuar Ancelotti.

Bostoni bie në shtëpi, Denveri merr kryesimin

Boston, 10 maj - Philadelphia triumfoi me rezultat 115-103 edhe në fushën e Bostonit, duke udhëhequr tashmë 3-2 serinë e gjysmëfinaleve "play-off" në Konferencën e Lindjes. Ndeshje e



KONFERENCA E LINDJES, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Boston - Philadelphia	2-3
New York - Miami	1-3

KONFERENCA E PERËNDIMIT, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Denver - Phoenix	3-2
Golden State - Lakers	1-3

dominuar nga skuadra e Philadelphia, që arriti një fitore me shumë peshë në fushën kundërshtare, pasi tani është vetëm një fitore larg finaleve në Lindje. Embiid me 33 pikë dhe Maxey me 30 pikë bënë dallimin në fushë për miqtë, mbështetur nga Hardeni me 17 pikë e Harrisin me 16. Për

Bostonin u dallua Tatum me 36 pikë, ndërsa Browni 24, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Në Konferencën e Perëndimit ekipi i Denverit udhëheq 3-2 serinë e takimeve, pas fitores me rezultat 118-102 ndaj Phoenixit, duke mos zhgënjyer në fushën e tij. Vendasit bënë një

paraqitje të mirë dhe u afrohen finaleve në këtë kah të NBA-së. Nikola Jokiqi, protagonist i fitores me një "triple double", me 29 pikë, 13 rebounde e 12 asistime, mbështetur nga Bruce Brown me 25 pikë. Për Phoenixin, dysjha Booker - Durant realizoi 54 pikë, por që mbetën për statistikë.

SHKURT

Operohet Kumbulla, humbet kualifikueset e qershorit

Një lajm i keq bëhet me dije për kombëtaren shqiptare të futbollit dhe për skuadrën e Romës. Mbrojtësi Marash Kumbulla iu nënshtrua një operacioni në gjurin e djathtë gjatë kësaj të marte, ndërsa si pasojë do të duhet të rrijë për disa muaj jashtë fushës së blertë. Kështu Marash Kumbulla do ta humbasë pjesën e mbetur të sezonit në Serinë A dhe kualifikueset e "Euro 2024" të kombëtares kuqezi që do të zhvillohen gjatë muajit qershor.

Mulleri nuk bën pjesë në planet e Tuchelit, afër 'divorcit' me Bayernin

Me katër nga gjashtë ndeshjet e fundit të nisura si zëvendësues, duket se "epoka" e Thomas Mullerit te Bayern Muncheni është drejt fundit dhe në merkaton e verës pritet "divorci" i mundshëm mes klubit dhe lojtarit, me këtë të fundit që deri para pak kohësh konsiderohej i "paprekshëm". Mirëpo ardhja e Thomas Tuchelit në krye të bankinës së "bavarezëve" duket se e ndryshoi këtë gjë, me 33-vjeçarin që nuk është në planet e teknikut gjerman, i cili kërkon të ketë një repart ofensivë të rifreskuar për sezonin e ardhshëm. Sipas prestigjiozes gjermane "Bild", mesfushori është duke menduar për t'i thënë "lamtumirë" futbollit profesionit, megjithatë për Mullerin nuk mungojnë oferta nga kampionati amerikan i futbollit, MLS, por dhe nga elita e futbollit në Arabinë Saudite.

Vdes futbollisti i parë që ka luajtur në pesë kampionate botërore

Legjenda e futbollit meksikan Antonio Carbajal, futbollisti i parë që ka luajtur në pesë Kupa të Botës, ka vdekur në moshën 93-vjeçare. I njohur si "La Tota", portieri ka luajtur në turnetë: "Brazili 1950", "Zvicër 1954", "Suedi 1958", "Kili 1962" dhe "Anglia 1966". Carbajal mbajti rekordin i vetëm për 32 vjet derisa u barazua nga Lothar Matthaus i Gjermanisë në 1998. Ai pati 48 paraqitje për vendin e tij, 11 prej të cilave në Kupat e Botës, përveç 409 paraqitjeve në nivel klubesh. Shumica e karrierës së tij 18-vjeçare si lojtar e kaloi në skuadrën meksikane Club Leon, ku luajti 364 ndeshje gjatë një qëndrimi 16-vjeçar.

Immabile refuzon ofertë 'faraonike' nga Arabia

Kapiteni i Lazios, Ciro Immobile, hodhi poshtë një ofertë fitimprurëse nga një klub saudit i paidentifikuar në mënyrë që ta mbyllë karrierën e tij në Romë. Ai ka shënuar 10 gola dhe ka asistuar 3 herë në 27 ndeshje në Serinë A, duke luajtur rolin e tij në luftën e ekipit për një pozicionim në top-katërshe. Immobile ka shënuar vetëm një gol në dy muajt e fundit për Lazio, duke u rikthyer në formë pasi u përfshi në një aksident automobilistik muajin e kaluar, i cili e la atë me një dëmtim të lehtë të shtyllës kurrizore, një frakturë në brinjë dhe një problem në krah. 33-vjeçari ka një kontratë deri në vitin 2026 me Lazio dhe mund ta rinovojë përsëri pas këtij afati.

Gjykata refuzon lirimin e Alvesit

Dani Alves që prej datës 20 janar të këtij viti ndodhet në burgun Brians 2 të Barcelonës, i akuzuar se ka përdhunuar një vajzë. Ai do

të vijojë të qëndrojë edhe për pak kohë pas hekurave. Brazilitani kishte bërë kërkesë për liri me kusht, por Gjykata Supreme e Katalonjës ka

refuzuar kërkesën e 40-vjeçarit, pavarësisht se ai ka garanci financiare dhe nuk është dënuar më parë. "Gjykata e distriktit të 15-të të

Barcelonës ka refuzuar kërkesën për lirimin me kusht nga ana e palës mbrojtëse", thuhet në një komunikatë të gjykatës

spanjolle. Hetimi për këtë çështje vijon ende, me mbrojtësin legjendar që shprehet se është i pafajshëm.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gazeta Lajm” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810101246 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gazeta Lajm” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810101246 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Gazeta Lajm” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810101246 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Premium Estate” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810102921 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Premium Estate” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810102921 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Premium Estate” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810102921 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Extra Cleaning” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811352616 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Extra Cleaning” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811352616 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Extra Cleaning” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811352616 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “UR” SH.P.K. me seli në Barilevë Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811284471 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “UR” D.O.O. od Barilevo Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811284471 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “UR” L.L.C. with headquarters Barileva Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811284471 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 531; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.63/2023 me nr. të protokollit 02-07/63, KMDK SH.A Përsërit këto:

KONKURSI PUBLIK-

(PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS)

Titulli:– Udhëheqës i Sektorit të Inxhinierisë I (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-7.1-2023

I raporton: Drejtorit të Operativës

Niveli i pagës: Niveli IV

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK SH.A

Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me konstruktimin e projekteve për investimet nëpër deponi;
- Harton përshkrimet teknike (me përmasa dhe llogari) të projekteve për rehabilitimin e infrastrukturës së DS dhe mbikëqyrë realizimin e punëve të kontraktuara me palët e treta;
- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me konstruktimin dhe investimet nëpër deponi;
- Harton planet vjetore për nevojat furnizuese për të gjitha llojet e materialeve të cilat përdoren për infrastrukturën e Deponive Sanitare dhe Stacion të Transferit të cilat janë të nevojshme për operimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e Deponive dhe i dorëzon tek Drejtori i Operativës;
- Përcjellë punën teknike në mirëmbajtje të të gjitha Deponive;
- Monitoron dhe menaxhon me zbatueshmërinë e projekteve kapitale nëpër Deponitë Sanitare dhe Stacion të Transferit,
- Jep këshilla dhe zgjedhje teknike për intervenime të domosdoshme në infrastrukturë, brenda deponive;
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë menaxhon me Njësinë Teknike dhe Njësinë e Mbrojtjes së Ambientit.
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me Menaxherët e Deponive dhe Udhëheqësit e Njësisë,
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Drejtorin e Operativës, bashkërendon aktivitetet operative në Deponitë Sanitare dhe Stacion të Transferit,
- Përgatitë raportet sipas kërkesës së DO, mujore, vjetore etj;
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë për punën e vet i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit të Operativës, sipas nevojës edhe Kryeshefit Ekzekutiv;

Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;
- Përvojë pune së paku 2 (dy) vite në fushën përkatëse;

Aftësitë kryesore

- Shkathësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, janë të nevojshme programet (Autocad, Archicad, Windows, Outlook, Microsoft Office dhe programe të llogaritjes së strukturës së stabilitetit etj.);
- Kapacitet për punë ekipore;
- Aftësi të mira komunikimi, me palët e interesit;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar

Titulli:– Operator teknik i sektorëve dhe urë matës I (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-9.2-2023

I raporton: Përgjegjësi i Deponisë

Niveli i pagës: IX

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: ST-Ferizaj

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Të bëjë pranimin, evidentimin dhe matjen e sasisë së mbeturinave të sjella me mjete transportuese të klientëve dhe të ruaj evidencat e secilës matje;
- Obligohet të përcjellë dhe të bëjë matjen e mjetit transportues si në hyrje edhe në dalje si dhe kujdeset që kur bëhet matja në automjet mos të jetë asnjë punëtor;
- Të mbaj pastër (kontejnerin) zyrën te peshorja;
- Obligohet që të përcjellë të gjitha lëvizjet brenda deponisë;
- Bën kontrollin dhe përcjellë nivelin e ujërave të zeza në lagunë dhe në sektor të mbeturinave;
- Në bazë të udhëzimeve të Përgjegjësit të Deponisë, lëshon pompat për ri qarkullimin e ujërave të zeza;
- Obligohet që të informojë PD për parregullsitë që hasë gjatë kontrollit të deponisë;
- Në bazë të udhëzimeve të PD bën lëvizjen e gypave ri qarkullues të ujërave të zeza për spërkatje;
- Sipas nevojave dhe kërkesës së PD kryen edhe punë tjera;
- Për punën e vet jep përgjegjësi PD.

Kualifikimet

-Diploma e shkollës së mesme;

Aftësitë kryesore

- Të ketë aftësi për të komunikuar me palë;
- Të jetë i aftë të punojë në ekip dhe nën presion.

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga “Bekim Fehmiu” Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedurë të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni
- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësisë.

- Çertifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënues për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së www.kmdk-ks.org, duke filluar nga data: 11.05.2023 deri me datën 25.05.2023 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyren e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Odetjon” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810800335.

- Xhevat Morina shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Nihat Skeja shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Liridona Paluca shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren.

- Ahmet Musaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.

- Mert Drini shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

- Petrit Rizvanolli shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së IV të shkollë së mesme ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.

- Elmenda Lushaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10, 11, 12 të gjimnazit “Hajdar Dushi, Gjakovë.

- Saranda Rama shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. të Mjekësisë, “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Arbëresha Muçaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasëve: I, II, III, IV si dhe diplomën e lëshuar nga SH.M e Mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU dd

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupcima zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., na osnovu Administrativnog uputstva (MPMS) br. KMDK SHA sa br. 63/2023 sa br. protokola 02-07/63 KMDK J.A. Ponavlja ovo:

JAVNI KONKURS

(ZA POPUNJAVANJE RADNIH MJESTA)

Zvanje: - Rukovodilac sektora inženjeringa 1 (jedna) pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-7.1-2023

Izveštava: Direktor operacija

Nivo plata: Nivo IV

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti

- Mjesečno i godišnje planiranje vezano za izgradnju projekata za ulaganja u deponije;
- Izrađuje tehničke opise (sa dimenzijama i proračunima) projekata sanacije infrastrukture DS i vrši nadzor nad izvođenjem radova ugovorenih sa trećim licima;
- Mjesečno i godišnje planiranje izgradnje i ulaganja u deponije;
- Izrađuje godišnje planove potreba za snabdijevanjem svih vrsta materijala koji se koriste za infrastrukturu sanitarnih deponija i transfer stanica neophodnih za rad, održavanje i rad deponija i dostavlja ih direktoru operacija;
- Izvodi tehničke poslove na održavanju svih deponija;
- Prati i upravlja primjenjivošću kapitalnih projekata na sanitarnim deponijama i transfer stanicama,
- Daje savjete i tehničke izbore za neophodne intervencije na infrastrukturi, unutar deponija;
- Rukovodilac Sektora inženjeringa rukovodi sa Tehničkom jedinicom i Jedinicom za zaštitu životne sredine.
- Rukovodilac sektora inženjeringa saraduje i koordinira aktivnosti sa menadžerima skladišta i rukovodiocima jedinica,
- Rukovodilac sektora inženjeringa u direktnoj saradnji sa direktorom operacija koordinira operativnim aktivnostima na sanitarnim deponijama i transfer stanicama,
- Izrada izvještaja prema zahtjevu DO, mjesečne, godišnje i sl.;
- Načelnik sektora za inženjering za svoj rad odgovara direktno direktoru operacija, a po potrebi i glavnom izvršnom direktoru

Kvalifikacije i radno iskustvo

- VSS, Građevinsko-arhitektonski fakultet;
- Radno iskustvo od najmanje 2 (dvije) godine u relevantnoj oblasti;

Ključne vještine

- Odlično poznavanje rada na računaru, neophodni su programi (Autocad, Archicad, Windows, Outlook, Microsoft Office i programi za proračun strukture stabilnosti itd.);
- Kapaciteti za timski rad;
- Dobre komunikacijske vještine sa zainteresovanim stranama;
- Poželjno je poznavanje govornog i pisanog engleskog jezika.

Zvanje: - Tehnički operater sektora i mjernog mosta 1 (Jedna) Radno mjesto

Referentni broj: ZP/KJ-9.2-2023

Izveštava: Upravitelj deponije

Nivo plata: IX

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: ST-Ferizaj

Dužnosti i odgovornosti:

- Prihvati, evidentira i izmjeri količinu otpada dovezenog vozilima kupaca i čuva evidenciju o svakom mjerenju;
- dužan je da prati i izmjeri transportno vozilo kako na ulazu tako i na izlazu, kao i da u vrijeme mjerenja nema radnika u vozilu;
- Održavati kancelariju za vaganje (kontejner) čistim;
- dužan je da prati sva kretanja unutar deponije;
- kontroliše i prati nivo otpadnih voda u laguni i sektoru otpada;
- na osnovu uputstava šefa deponije pušta pumpe za recirkulaciju otpadnih voda;
- dužan je obavijestiti UP o svim nepravilnostima na koje se uoče tokom inspekcije deponije;
- Na osnovu uputstava DP-a vrši pomicanje recirkulacijskih kanizacionih cijevi za prskanje;

- Prema potrebama i zahtjevima DP-a obavlja i druge poslove;

- PD daje odgovornost za svoj rad.

Kvalifikacija

- Srednjoškolska diploma;

Ključne vještine

- Da ima sposobnost komuniciranja sa strankama;
- Da mogu raditi u timu i pod pritiskom.

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrište. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- Aplikacija
- Životopis,
- Diploma,
- certifikate o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.
- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja)





Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 11.05.2023. do 25.05.2023. godine, 08:00-16:00 časova.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.

		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo		Zyra Kombëtare e Auditimit Nacionalna Kancelarija Revizije National Audit Office
NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT		
Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 13.04.2023, për vendin e punës:		
I. Pozita: Zyrtar i Lartë Ligjor Numri i referencës: ZLL/ZKA/02-04/23		
Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 655 të datës 10.05.2023.		
Prishtinë, 10.05.2023	Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 	
OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA		
Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 13.04.2023. godine, za radno mesto:		
I. Položaj: Visoki pravni službenik Broj reference: ZLL/ZKA/02-04/23		
Konkurs se otkazuje na osnovu br. 655 od datuma 10.05.2023.		
Priština, 10.05.2023	Departman za upravljanje ljudskim resursima 	

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMINALE
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE
"TRAFIKU URBAN" SH.A.
PRISHTINE
Nr. 1514 dt. 10-05-2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016, nenit 5 paragrafi 5, nenit 16 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III/nr. 31/15 qershor 2008), dhe plotësim ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr. 04/L-111 dhe nr. 05/L-009, dhe në pajtim me normat tjera pozitive relevante, nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, nenit 13 të Statutit të NPK "Trafiku Urban" SHA. nr. 1173 dt. 05.04.2023 dhe vendimit nr. 1512 dt. 10.05.2023 të datë 10.05.2023 Komisioni Komunal i Aksionarëve të NPK "TRAFIKU URBAN" SHA. në Prishtinë, me datën 10.05.2023 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Pozitat: Drejtor të Bordit Drejtues të N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. Prishtinë.

Numri i Pozitave: 4 (katër)

I përgjigjen: Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. Prishtinë.

Mandati: 3 (tre) vite.

Kompensimi: Konform nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimeve përkatëse.

1. Të përgjithshme

Kandidati/ja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

2. Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë

Çdo kandidatë për t'u konsideruar në pozitën e Drejtorit të Bordit, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhimit në fushat si vijon: në administrim të biznesit; - financa të korporatave; - financa; - menaxhim thesari; - banka; - konsulentë në biznes ose industri; ose - nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë, e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste - të ndërmarrjes; ose për së paku pesë (5) vite, të ketë

qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar- i kualifikuar i një profesioni tjetër, i cili ndër lidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

3. Papajtueshmëria

Konform ligjit në fuqi, një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjeve publike, nëse:

a) Ka qenë i/e dënuar nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës; ka kryer vepër penale ose civile, vepër që përfshinë përgjeshtrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve; ka qenë i/e përfshirë në mitosje apo rryshfet sipas ligjeve apo rregullore në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;

b) është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keqpërdorur apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se ka keqpërdorur apo keqpërvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;

c) ka bërë përgjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe

d) është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara;

e) punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

3.1 Të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

a) aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;

b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;

c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç; si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

e) pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç; honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të ligjit primar, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;

f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;

g) përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;

h) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të llastuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen; dhe

i) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

j) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

4. Dokumentacioni i nevojshëm.

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Drejtorëve, konform këtij konkursi, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin (merret në zyrën e ndërmarrjes ose në web faqe të ndërmarrjes, www.trafikurban-pr.com)

- CV-në e detajuar


- Letër motivimin

- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional të noterizuar (Diplomat/Certifikatat dhe dokumente të ngjashme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara).

- Dëshmitë mbi përvojën e punës e vërtetuar me trustin pensional (Aplikacioni duhet të ofrojë të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese).

- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se tre muaj)

- Deklaratën nën betim (merret në zyrat e ndërmarrjes, ose në ueb faqe te ndërmarrjes).



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Na osnovu člana 164 Zakona o privrednim društvima 06/L-016, člana 5 stav 5, člana 16 i 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 (Službeni list Republike Kosovo/Priština: godina III/br. 31/15. jun 2008), i dopunjava relevantne izmene Zakonom br. 04/L-111 i br. 05/L-009, au skladu sa drugim relevantnim pozitivnim normama, član 20. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, član 13 Statuta NPK „Trafiku Urban“ SHA, broj 1173 od 05.04.2023.godine i rešenje broj 1512 od 10.05.2023.godine od 10.05.2023.godine Opštinska komisija akcionara NPK „TRAFIKU URBAN“ SHA, u Prištini, dana 10.05.2023. saopštava:

JAVNI KONKURS

Funkcije: Funkcije Upravnog Odbora NPK „Trafiku Urban“ SHA, Priština.

Broj pozicija: 4 (četiri)

Odgovaraju: Opštinskoj Komisiji Akcionara NPK „Trafiku Urban“ SHA, Priština.

Mandat: 3 (tri) godine.

Naknada: U skladu sa članom 20. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, i dovršiti relevantne izmene.

1. Generalno

Kandidati za ovu poziciju moraju biti lice od integriteta, koje ispunjava kvalifikacione uslove i kriterijume nezavisnosti, da poseduje potrebno stručno iskustvo i traženu stručnu spremu, kao i da ispunjava druge uslove propisane odredbama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća i druga relevantna pozitivna akta.

2. Uslovi stručne spreme i podobnosti

Svaki kandidat koji se razmatraju za poziciju direktora odbora moraju imati najmanje pet (5) godina iskustva - najmanje na visokom nivou menadžmenta u sledećim oblastima: u poslovnoj administraciji; korporativne finansije; - finansije; - upravljanje trezorom; - banka; - konsultantske usluge u poslovanju ili industriji; ili iz druge oblasti nauke ili znanja, koja je u vezi sa poslovnim delatnošću - preduzeća; ili najmanje pet (5) godina da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani član druge profesije koja je usko povezana sa poslovnim delatnošću JP.

3. Nekompatibilnost

Prema važećem zakonu, lice nema pravo da bude direktor u odboru javnih preduzeća, ako:

- je izrečena kazna od nadležnog suda, osim ako je ovu kaznu ili odluku naknadno preinačio drugi sud na osnovu žalbe; je počinio krivično ili građansko delo, krivično delo, uključuje falsifikovanje, lažno predstavljanje, korupciju, krađu, pranje novca, proneveru, proneveru ili lažnu raspodelu sredstava; je bio umešan u podmićivanje ili podmićivanje u skladu sa zakonima ili propisima koji su na snazi na Kosovu ili bilo kojoj drugoj zemlji, ili prema međunarodnim ugovorima ili konvencijama;
- ako je odlučio sud ili telo ili organizacija odgovorna za primenu etičkog kodeksa ili standarda profesionalnog ponašanja, osim ako ovu kaznu ili odluku naknadno ne promeni drugi sud ili telo na osnovu pritužbe (i) da je angažovan u neprofesionalnom ponašanju, (ii) da je prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, (iii) da je prisvojio ili zloupotrebio novac ili javna sredstva, (iv) da je zloupotrebio ili prisvojio informacije (podatke), zarađen tokom službe kao javni službenik ili državni službenik, ili (v) da je zloupotrebio javnu funkciju ili položaj u državnoj službi za ličnu korist ili za korist ili korist rođaka ili poznanika; ili;
- je dao materijalne demantije pod bilo kojim svedočenjem pod zakletvom ili drugom zakletvom, ili zapečaćenom ili overenom ispravom; i
- je proglašen bankrotom u poslednjih deset (10) godina;
- radi u bilo kojoj instituciji u kojoj se kreiraju razvojne politike za relevantno Javno preduzeće u kojem kandidat radi.

3.1 Svi direktori moraju biti nezavisni. Lice se ne smatra nezavisnim i ne može biti izabrano za direktora u JP ako:

- je trenutno službenik ili menadžer relevantnog JP ili bilo koje njegove podružnice, ili je služio kao službenik ili menadžer relevantnog JP ili bilo koje njegove podružnice u proteklih pet (5) godina;
- je trenutno zaposleni na visokom nivou u relevantnom JP, ili je radio kao zaposleni na visokom nivou u relevantnom JP u poslednje tri (3) godine;
- ima trenutno, ili tokom poslednje tri godine, bilo kakve materijalne poslovne odnose (osim: kao pojedinačni potrošač usluga JP) sa relevantnim JP ili bilo kojim od njegovih podružnica, bilo direktno ili indirektno poprečno;
- je akcionar, direktor, funkcioner ili viši službenik u privrednom društvu ili drugom pravnom licu koje ima materijalni poslovni odnos sa relevantnim NP ili bilo kojim od njegovih zavisnih preduzeća;
- prihvata, ili je prihvatio u protekle tri (3) godine, dodatnu nadoknadu od relevantnog JP ili bilo kog od njegovih filijala (osim: honorar direktora ili podsticajna naknada definisana u članu 20.1 primarnog zakona, ili je član šemu penzije relevantnog JP ili bilo koje njegove podružnice;
- ima zajedničke direktorske funkcije ili ima značajne veze sa drugim direktorima relevantnog JP kroz učešće u drugim privrednim društvima ili telima;
- predstavlja akcionara koji poseduje deset procenata (10%) akcija sa pravom glasa u relevantnom JP;
- je ili (i) zaposleni, službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u komercijalnoj kompaniji koja nije kotirana na berzi koja se takmiči sa Preduzećem, ili (ii) viši menadžer, službenik, direktor ili akcionar (i koji poseduje više od dva procenta (2%) glasačkih prava, ili ima značajan finansijski interes u bilo kojoj od razmaženih komercijalnih kompanija koje se takmiče sa Preduzećem; i
- je ili je u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma podnošenja zahteva bio (i) izabrani javni zvaničnik, (ii) politički imenovani ili (iii) nosilac rukovodstva ili pozicije na kojoj se donose odluke u politička partija;
- ima bilo kakav sukob interesa koji bi, po svojoj prirodi, doveo do toga da ovo lice ne bude u stanju da rutinski, verno, nezavisno i objektivno ispunjava svoje fiducijarne obaveze prema Akcionarima i JP-u.

4. Potrebna dokumentacija.

Kandidati za direktore u Upravnom odboru, u skladu sa ovim konkursom, moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Prijava (primljena u kancelariji kompanije ili na sajtu kompanije) www.trafikurban-pr.com
- Detaljan CV
- Motivaciono pismo

- Dokaz o stručnoj kvalifikaciji kod javnog beležnika (Diplome/Sertifikati i slični dokumenti dobijeni u inostranstvu moraju biti overeni kod notara).
- Dokaz o radnom iskustvu overen kod penzijskog fonda (u aplikaciji moraju biti navedeni tačni podaci o periodima angažovanja i da odgovara pratećoj dokumentaciji).
- Uverenje koje nije pod istragom (ne starije od tri meseca)
- Izjava pod zakletvom (dobija se u kancelarijama kompanije, ili na sajtu kompanije).

Ovim dokumentom kandidat izjavljuje da ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti iz st. 1-3 člana 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087. **Svaki materijalni falsifikovanje – bilo namerno ili iz nemara – ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi će dovesti do momentalne diskvalifikacije osobe i, ako je primenljivo, uklanjanja.**

- Kopija lične karte ili pasoša

• Kontrolna lista (dostupna u kancelariji preduzeća ili na veb stranici preduzeća).

5. Informacija o konkursnoj proceduri.

Javni konkurs će biti otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi od **11.05.2023** godine do **09.06.2023** godine. Dokumentaciju podnosilaca prijava potrebno je dostaviti u arhivi N.P.K. „TRAFIKU URBAN“ SHA, u Prištini, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova u zatvorenoj koverti, ili poštom, obraćajući se Opštinskoj komisiji akcionara N.P.K. „TRAFIKU URBAN“ SH.A. Rr. Tahir Zajmi - 10000 u Prištini – sa titulom „Prijava za direktora odbora“. Svi dokumenti moraju biti dostavljeni u overenim kopijama, dok će njihovi originali biti potrebni u kasnijim fazama selekcije. Dodatne informacije mogu se dobiti putem e-mail adrese: info@trafikurban-pr.com ili direktno u arhivi Kompanije. Prijave dostavljene nakon roka i nepotpune neće se razmatrati. Svi obrasci moraju biti popunjeni u celini, nepopunjavanje i netačne informacije će dovesti do momentalne diskvalifikacije i, ako je primenljivo, uklanjanja osobe.

Opštinska komisija akcionara će razviti otvorenu/transparentnu i konkurentnu proceduru, gde će se izbor vršiti isključivo na osnovu zasluga, u skladu sa važećim zakonima i bez ikakve diskriminacije, za šta podstiče kandidate da se prijave:

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

Kompanija nudi jednake mogućnosti zapošljavanja, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Opštinska Komisija Akcionara Javnog Preduzeća NPK „Trafiku Urban“ SHA Priština.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues